

**KISI-BIO-ENERGJI sh. p. k.**

**Pasqyrat Financiare Individuale  
për vitin e mbyllur më 31dhjetor 2020**



Emërtimi dhe forma ligjore: **KISI-BIO-ENERGJI SH.P.K.**  
NIPT (NUIS): **K86907701E**  
Adresa e selisë: **Rr. "Rreshit Çollaku", Pallatet "Shallvare", Sh.17,  
Ap. 249, Nj.B. 10, Tiranë**  
Data e krijimit: **04.07.2008**  
Veprimtaria kryesore: **Financimi, projektimi, ndërtimi, vënia në punë, administrimi, prodhimi, shpërndarja, eksportimi dhe shitja e energjisë së përfituar, mirëmbajtja e hidrocentralit "Kacni" që do të ndërtohet në rrjedhën e përroit të peshkut në rrethin e Dibrës, si dhe transferimi i tij në përfundim të Kontratës së Koncensionit nga Koncensionari tek Autoriteti Kontraktues.**

**PASQYRAT FINANCIARE INDIVIDUALE  
PËR VITIN E MBYLLYR MË 31 DHJETOR 2020**

Pasqyrat Financiare janë individuale:	Po
Pasqyrat Financiare janë të konsoliduara:	Jo
Pasqyrat Financiare janë të shprehura në:	Lekë
Pasqyrat Financiare janë të rrumbullakosura në:	Lekë
Periudha kontabël e Pasqyrave Financiare:	Nga 01.01.2020 deri më 31.12.2020
Data e mbylljes së Pasqyrave Financiare:	29.03.2021



## **Përmbajtja:**

	<b>Faqe</b>
Pasqyra e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2020	3
Pasqyra e performancës dhe të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020	4
Pasqyra e ndryshimeve në kapitalin neto për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020	5
Pasqyra e fluksit të mjeteve monetare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020	6
Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare	7 - 19

# KISI-BIO-ENERGJI Sh. p. k.


## Pasqyra e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2020

(shumat në Lek)


	Shënime	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019 (rishikuar)
<b><u>Aktivitet</u></b>			
<b>Aktivitet afatshkurtra</b>			
Mjete monetare	4	11,402,068	98,930
Të drejta të arkëtueshme	5	12,355,980	18,565,966
Shpenzime të shtyra	6	76,068	51,725
<b>Totali i aktiveve afatshkurtra</b>		<b>23,834,116</b>	<b>18,716,621</b>
<b>Aktivitet afatgjata</b>			
Aktive materiale	7	337,318	154,557
Aktive jo materiale	8	389,496,082	372,312,121
<b>Totali i aktiveve afatgjata</b>		<b>389,833,400</b>	<b>372,466,678</b>
<b>Totali i aktiveve</b>		<b>413,667,516</b>	<b>391,183,299</b>
<b><u>Detyrime dhe kapitali</u></b>			
<b>Detyrime afatshkurtra</b>			
Detyrime afatshkurtra	9	14,414,985	40,748,648
Të ardhura të shtyra		-	-
Provizione		-	-
<b>Totali i detyrimeve afatshkurtra</b>		<b>14,414,985</b>	<b>40,748,648</b>
<b>Detyrime afatgjata</b>			
Detyrime afatgjata	10	157,992,941	148,835,713
<b>Totali i detyrimeve afatgjata</b>		<b>157,992,941</b>	<b>148,835,713</b>
<b>Totali i detyrimeve</b>		<b>172,407,926</b>	<b>189,584,361</b>
<b>Kapitali dhe rezervat</b>			
Kapitali i nënshkruar	1	241,757,650	202,600,000
Rezerva të tjera		59,074	59,074
Fitimi (humbja) i pashpërndarë		(1,060,136)	9,663,247
Fitimi (humbja) e vitit		503,002	(10,723,383)
<b>Totali i kapitalit</b>		<b>241,259,590</b>	<b>201,598,938</b>
<b>Totali i detyrimeve dhe kapitalit</b>		<b>413,667,516</b>	<b>391,183,299</b>

Pasqyra e pozicionit financiar duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 7 – 19 që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

Pasqyrat financiare të Shoqërisë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 u aprovuan nga Bordi Drejtues i Kisi-Bio-Energji Sh.p.k. dhe u nënshkruan si më poshtë më 30 mars 2021.

  
Julian Cella  
Administrator



  
Brunila Leskaj  
Kontabël i Miratuar  
IIM&H Business Sh.p.k.  
Rr. Abdi Toptani, Torre Drin, Kati 4  
Tiranë, Shqipëri

# KISI-BIO-ENERGJI Sh. p. k.

## Pasqyra e performancës dhe të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

(shumat në Lek)

	Shënime	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2020	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2019 (rishikuar)
<b>Të ardhurat nga aktiviteti i shfrytëzimit:</b>			
Të ardhurat nga shitja	11	38,118,963	27,149,572
Ndryshimet në inventarin e produkteve të gatshme dhe prodhimet në proces		-	-
Të ardhura të tjera të shfrytëzimit		-	-
<b>Totali i të ardhurave nga aktiviteti i shfrytëzimit</b>		<b>38,118,963</b>	<b>27,149,572</b>
<b>Shpenzimet:</b>			
Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme		-	-
Shpenzime të personelit:	12		
Paga dhe shpërblime		(10,258,373)	(5,540,195)
Shpenzime për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore		(1,293,728)	(910,182)
Zhvlerësimi i aktiveve afatgjata materiale		-	-
Amortizimi dhe shpenzime konsumi	7, 8	(17,048,036)	(15,934,561)
Shpenzime të tjera shfrytëzimi	13	(5,850,441)	(6,288,574)
<b>Totali i shpenzimeve</b>		<b>(34,450,578)</b>	<b>(28,673,512)</b>
Të ardhura të tjera		-	-
Zhvlerësimi i aktiveve dhe investimeve financiare të mbajtura si aktive afatshkurtra		-	-
<b>Të ardhurat dhe shpenzime financiare:</b>			
Të ardhura (shpenzime) nga interesat dhe të ngjashme, neto	14	(293)	(8,844,997)
Të ardhura (shpenzime) nga kursi i këmbimit, neto	15	(2,958,735)	254,073
<b>Totali i të ardhurave dhe shpenzimeve financiare</b>		<b>(2,959,028)</b>	<b>(8,590,924)</b>
Pjesa e fitimit (humbjes) nga pjesëmarrjet		-	-
Fitimi (humbja) para tatimit		709,357	(10,114,864)
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin	16	(206,355)	(608,519)
<b>Fitimi (humbja) e vitit</b>		<b>503,002</b>	<b>(10,723,383)</b>
<b>Pasqyra e të ardhurave gjithëpërfshirëse</b>			
<b>Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse për vitin:</b>			
Diferencat nga përkthimi i monedhës në veprimtari të huaja		-	-
Diferencat nga rivlerësimi i aktiveve afatgjata materiale		-	-
Diferencat nga rivlerësimi i aktiveve financiare të mbajtura për shitje		-	-
Pjesa e të ardhurave gjithëpërfshirëse nga pjesëmarrjet		-	-
<b>Totali i të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse për vitin</b>		<b>503,002</b>	<b>(10,723,383)</b>

Pasqyra e performancës dhe të ardhurave gjithëpërfshirëse duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 7 – 19 që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.



## KISI-BIO-ENERGJI Sh. p. k.

Pasqyra e ndryshimeve në kapitalin neto për vitin e mbylltur më 31 dhjetor 2020

(shumat në Lek)

	Kapitali i nënshkruar	Rezerva ligjore	Fitimet (humbjet) e pashpërndara	Totali
<b>Pozicioni më 1 janar 2019 (rishikuar)</b>	194,900,000	76,635	17,345,686	212,322,321
Të ardhura (humbje) gjithëpërfshirëse për vitin:	-	-	(10,723,383)	(10,723,383)
Fitimi (humbja) e vitit (riparaqitur)	-	-	-	-
Të ardhura (humbje) të tjera gjithëpërfshirëse për vitin	-	-	(10,723,383)	(10,723,383)
<b>Të ardhura (humbje) totale gjithëpërfshirëse për vitin</b>	-	-	-	-
Transaksionet me pronarët e njësisë ekonomike të njohura direkt në kapital:	-	-	-	-
Emetimi i kapitalit të nënshkruar	7,700,000	(17,561)	(7,682,439)	-
Kapitalizim i fitimit pas tatimit	-	-	-	-
Dividendë të paguar	7,700,000	(17,561)	(7,682,439)	-
<b>Totali i transaksioneve me pronarët e njësisë ekonomike</b>	202,600,000	59,074	(1,060,136)	201,598,938
<b>Pozicioni më 31 dhjetor 2019 (rishikuar)</b>	202,600,000	59,074	(1,060,136)	201,598,938
<b>Pozicioni më 1 janar 2020</b>	-	-	503,002	503,002
Të ardhura (humbje) gjithëpërfshirëse për vitin:	-	-	-	-
Fitimi (humbja) e vitit	-	-	503,002	503,002
Të ardhura (humbje) të tjera gjithëpërfshirëse për vitin	-	-	-	-
<b>Të ardhura (humbje) totale gjithëpërfshirëse për vitin</b>	-	-	503,002	503,002
Transaksionet me pronarët e njësisë ekonomike të njohura direkt në kapital:	39,157,650	-	-	39,157,650
Emetimi i kapitalit të nënshkruar	-	-	-	-
Kapitalizim i fitimit pas tatimit	-	-	-	-
Dividendë të paguar	39,157,650	-	-	39,157,650
<b>Totali i transaksioneve me pronarët e njësisë ekonomike</b>	241,757,650	59,074	(557,134)	241,259,590
<b>Pozicioni më 31 dhjetor 2020</b>	241,757,650	59,074	(557,134)	241,259,590

Pasqyra e ndryshimeve në kapitalin neto duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 7 – 19 që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

# KISI-BIO-ENERGJI Sh. p. k.

## Pasqyra e fluksit të mjeteve monetare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

(shumat në Lek)

Shënime	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2020	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2019 (rishikuar)
<b>Fluksi monetar nga (përdorur në) veprimtaritë e shfrytëzimit:</b>		
Fitimi (humbja) e vitit	503,002	(10,723,383)
<i>Rregullime për shpenzimet jomonetare:</i>		
Shpenzimet financiare jomonetare	2,346,297	-
Shpenzimi për tatimin mbi fitimin	206,355	608,519
Shpenzime amortizimi	17,048,036	15,934,561
<i>Ndryshimet në aktivet dhe detyrimet e shfrytëzimit:</i>		
Rënie (ritje) në të drejtat e arkëtueshme dhe të tjera	5,978,488	19,893,656
Rritje (rënie) në detyrimet e pagueshme	(26,255,491)	(43,770,896)
<b>Mjete monetare neto nga (përdorur në) veprimtaritë e shfrytëzimit</b>	<b>(173,313)</b>	<b>(18,057,543)</b>
<b>Fluksi i mjeteve monetare nga (përdorur në) aktivitetin e investimit:</b>		
Pagesa për blerjen e aktiveve afatgjata materiale	(217,808)	-
Pagesa për blerjen e aktiveve afatgjata jo materiale	(34,196,950)	-
<b>Mjete monetare neto nga (përdorur në) veprimtaritë e investimit</b>	<b>(34,414,758)</b>	<b>-</b>
<b>Fluksi i mjeteve monetare nga (përdorur në) aktivitetin e financimit:</b>		
Arkëtime nga emetimi i kapitalit	39,157,650	-
Arkëtime nga financimet	6,854,777	18,119,695
<b>Mjete monetare neto nga (përdorur në) veprimtaritë e financimit</b>	<b>46,012,427</b>	<b>18,119,695</b>
<b>Rritje (rënie) neto në mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare</b>	<b>11,424,356</b>	<b>62,152</b>
<b>Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 1 janar</b>	<b>98,930</b>	<b>36,778</b>
<i>Efëkti i luhatjeve të kurseve të këmbimit të mjeteve monetare</i>	<i>(121,218)</i>	<i>-</i>
<b>Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 31 dhjetor</b>	<b>4 11,402,068</b>	<b>98,930</b>

Pasqyra e flukseve monetare duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 7-19 që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

# KISI-BIO-ENERGJI Sh. p. k.

## Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

(shumat në Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

### 1. Informacion i përgjithshëm

Kisi-Bio-Energji sh.p.k. (më poshtë referuar si "Shoqëria" dhe/ose "Koncesionari") është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e themeluar më 4 korrik 2008 dhe regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit ("QKB") më 7 korrik 2008.

Aktiviteti kryesor i Shoqërisë konsiston në financimin, projektimin, ndërtimin, vënien në punë, administrimin, prodhimin, shpërndarjen, eksportimin dhe shitjen e energjisë së përfituar si dhe mirëmbajtjen e hidrocentralit "Kacni" ("HEC Kacni") i cili është ndërtuar në rrjedhën e përroit të peshkut në rrethin e Dibrës. Ndërtimi dhe operimi i deritanishëm i HEC Kacni është kryer bazuar në dhe në përputhje me Kontratën e Koncesioni, tipi BOT, datë 5 maj 2008, miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave nr. 568 date 5 maj 2008, botuar në Fletore Zyrtare nr. 77/2008 datë 29 maj 2008 (në vijim referuar si "Kontrata e Koncesionit"). Data e fillimit të koncesionit është data 29 maj 2008 dhe koncesioni ka një kohëzgjatje 35 vjecare. Në përfundim të Kontratës së Koncesionit, do të kryehet transferimi i hidrocentralit nga Koncesionari tek Autoriteti Kontraktues.

Kapitali i nënshkruar i paguar i Shoqërisë më 31 dhjetor 2020 është 241,757,650 Lek (31 dhjetor 2019: 202,600,000 Lek).

Struktura e ortakëve të Shoqërisë si dhe gjendja e kapitalit më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 janë si më poshtë:

Ortaku	31 dhjetor 2020		31 dhjetor 2019	
	Vlera në Lekë	%	Vlera në Lekë	%
FreeCo Sh.p.k.	241,757,650	100%	202,600,000	100%
<b>Totali</b>	<b>241,757,650</b>	<b>100%</b>	<b>202,600,000</b>	<b>100%</b>

	Kapitali i nënshkruar	Kapitali i nënshkruar i papaguar	Totali i kapitalit të nënshkruar të paguar
<b>Kapitali i nënshkruar më 1 janar 2019</b>	<b>194,900,000</b>	-	<b>194,900,000</b>
Emetim i kapitalit	7,700,000	-	7,700,000
<b>Kapitali i nënshkruar më 31 dhjetor 2019</b>	<b>202,600,000</b>	-	<b>202,600,000</b>
Emetim i kapitalit	39,157,650	-	39,157,650
<b>Kapitali i nënshkruar më 31 dhjetor 2020</b>	<b>241,757,650</b>	-	<b>241,757,650</b>

Përfaqësues ligjorë të Shoqërisë gjatë vitit 2020 kanë qenë:

- Znj. Daniela Lecka për periudhën deri më 21 janar 2020;
- Z. Julian Cela dhe Znj. Ardita Rama me efekt nga data 21 janar 2020 dhe deri më 31 mars 2021.

NUIS i Shoqërisë është K86907701E dhe adresa kryesore e saj është në: Rruga "Rreshit Çollaku", Pallatet "Shallvare", Shkalla 17, Apartamenti 249, Tiranë. Shoqëria ka adresë dytësore dhe në vendndodhjen e HEC Kacni në Dibër, Selishtë, Fshati Kacni.

Numri mesatar i punonjësve të Shoqërisë gjatë vitit 2020 është 11 (viti 2019 : 11).



# KISI-BIO-ENERGJI Sh. p. k.

## Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

(shumat në Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

---

### 2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare

#### 2.1 Bazat e përgatitjes

Pasqyrat financiare individuale janë përgatitur duke respektuar parimin e vijueshmërisë, kërkesat e Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit, të përmirësuara (SKK) të cilat janë të aplikueshme në mënyre prospektive duke filluar nga data 1 janar 2019 si dhe kërkesat e Ligjit nr. 25/2018 ‘Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat financiare’ i cili ka hyrë në fuqi më 1 janar 2019.

#### 2.2 Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike. Bazat e matjes për çdo aktiv, detyrim, të ardhur dhe shpenzim janë përshkruar në detaje në shënimet shpjeguese në vijim.

#### 2.3 Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë prezantuar në Lek, e cila është dhe monedha funksionale e Shoqërisë.

#### 2.4 Vlerësime dhe gjykime

Përgatitja e pasqyrave financiare kërkon nga drejtuesit të ushtrorjnjë gjykimin e tyre në procesin e zbatimit të politikave kontabël të shoqërisë dhe shumave të raportuara të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultati aktual mund të ndryshojë në varësi të këtyre vlerësimeve.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabël njihen në periudhën në të cilën vlerësimi është rishikuar si dhe në periudhat e ardhshme që preken.

Në veçanti, informacion mbi fushat më të rëndësishme të vlerësimeve dhe gjykimeve në aplikimin e politikave kontabël të cilat kanë efektet më të rëndësishme në shumat e njohura në pasqyrat financiare, janë përshkruar në shënimet përkatëse të pasqyrave financiare. Përdorimi i vlerësimeve kontabël është minimal në këto pasqyra financiare duke pasur parasysh thjeshtësinë e veprimeve të realizuara nga Shoqëria.

#### 2.5 Ndryshimet në politikat kontabël

Me përjashtim të ndryshimeve si më poshtë, Shoqëria ka aplikuar në mënyrë të vazhdueshme politikat kontabël sipas përcaktimeve në shënimin 3, për të gjitha periudhat e paraqitura në këto pasqyra financiare.

- Adoptim restrospektiv i SKK 13 Aktivitet Biologjike dhe Marrëveshjet e Koncesionit, të përmirësuara, duke filluar për periudhat duke filluar nga data 1 janar 2015, datë e hyrjes në fuqi të këtij standardi.

Natyra dhe efektet e aplikimit në retrospektivë të SKK 13 janë shpjeguar më poshtë.

Si rezultat i parashikimeve të SKK 13 “Aktivitet Biologjike dhe Marrëveshjet e Koncesionit”, i përmirësuar, në vitin 2020 Shoqëria ka ndryshuar politikën e saj kontabël në kontabilizimin e marrëveshjeve koncesionare me efekt retrospektiv duke filluar nga periudha e cila nis më 1 janar 2015 e në vazhdim. Si rezultat i ndryshimit, Shoqëria ka njohur një aktiv jo-material marrë në këmbim të ndërtimit të një aktivi në një marrëveshje koncesionare, ndërsa më parë këto aktive ishin njohur si aktive afatgjata të materiale. Efekti korrigjues i aplikimit në retrospektivë të parashikimeve të SKK 13 për vitet 2015 – 2018 është njohur dhe paraqitur nga Shoqëria në balancën fillestare të periudhës krahasuese në këto pasqyra financiare ndërsa pasqyrat krahasuese, të cilat përkrijnë me vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019, janë riparaqitur duke respektuar kërkesat e SKK 13. Efektet e aplikimit në mënyrë retrospektive të SKK 13 për periudhat nga 1 janar 2015 e deri më 1 janar 2019 paraqiten në shënimin 3.10 në këto pasqyra financiare.

Jeta e dobishme e pritshme e aktiveve dhe metodat e zhvlerësimit dhe amortizimit kanë ndryshuar siç përshkruhet në politikën kontabël 3.4.

### 3. Politikat kontabël

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat të paraqitura në pasqyrat financiare.

#### 3.1 Transaksionet dhe balancat në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivitet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e raportimit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj

# KISI-BIO-ENERGJI Sh. p. k.

## Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

(shumat në Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmben në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse

Zërat jomonetare të cilat përllogariten me kosto historike në monedhë të huaj, konvertohen duke përdorur kurset e këmbimit të datave të transaksionit fillestar. Zërat jomonetare të cilat njihen me vlerën e drejtë, në monedhë të huaj, konvertohen duke përdorur kurset e këmbimit në datën kur përcaktohet vlera e drejtë. Humbja ose fitimi që rezulton nga konvertimi i zërave jomonetare trajtohet në të njëjtën mënyrë si njohja e humbjes ose fitimit nga ndryshimi i vlerës së drejtë të zërave të pasqyrës së pozicionit financiar (p.sh. diferencat e konvertimit në zëra të cilave u njihet humbja ose fitimi në pasqyrën e performancës).

	31 Dhjetor 2020	31 Dhjetor 2019
1 EUR	123.70	121.77

### 3.2 Instrumenta financiarë

Instrumentat financiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna, dhe llogari të pagueshme. Një instrument financiar njihet nëse shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit.

Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentet e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbje, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Në vijim të njohjes fillestare instrumentet financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë.

Aktivitet financiarë çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitet financiar ose kur shoqëria transferon aktivitet financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitet. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare njihen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivitet. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

#### *Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre*

Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat me bankat si dhe investime të tjera afatshkurtra shumë likuide me maturim origjinal tre ose më pak muaj, të cilat janë objekt rreziku jo domethënës ndaj ndryshimeve në vlerë dhe që përdoren nga Shoqëria në menaxhimin e detyrimeve të saj afatshkurtra.

#### *Llogari të arkëtueshme*

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbriturhumbjen nga zhvlerësimi. Provizionit për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

#### *Llogari të pagueshme*

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

#### *Hua të marra dhe të dhëna*

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht dhe mbahen në vazhdim me vlerën e drejtë, pa përfshirë koston e transaksioneve.

#### *Vlera e drejtë*

Vlerat e drejta të përllogaritura të mjeteve monetare dhe ekuivalenteve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar dhe huave përafrohen me vlerat e tyre kontabël.

#### *Të tjera*

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

# KISI-BIO-ENERGJI Sh. p. k.

## Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

(shumat në Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

### Kapitali aksionar

Kapitali aksionar njihet me vlerën nominale. Aksionet e zakonshme klasifikohen si kapitale.

### 3.3 Aktive afatgjata materiale

#### (i) Njohja dhe matja

Të gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar.

Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen me blerjen e aktivit si dhe kosto të tjera direkte që lidhen me sjelljen e aktivit në vendndodhjen dhe kushtet e nevojshme për funksionimin e tij. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe koston e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendje e mëparshme të vendndodhjes së aktivit. Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në "Ndërtim në proces" dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivit kur përfundon ndërtimi tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë. Në koston e aktivit nuk përfshihen koston e huamarrjes të cilat njihen si shpenzime në momentin kur ato ndodhin.

Në rastet kur pjesë të një aktivi afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur, dhe këto përfshihen në të ardhura të tjera në pasqyrën e performancës.

#### (ii) Kostot vijuese

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afat-gjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

#### (iii) Amortizimi

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën e vlerës së mbetur të amortizimit, mbi jetën e dobishme të vlerësuar të çdo pjese të aktivit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivet e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivit. Toka nuk amortizohet.

Metoda e amortizimit, jeta e dobishme dhe vlera e mbetur rishikohen në çdo datë raportimi.

Metodat e llogaritjes dhe përqindjet e amortizimit për secilën kategori aktivesh afatgjata për periudhën aktuale dhe atë krahasuese janë si më poshtë:

Mobilje dhe pajisje zyre	Mbi vlerën kontabël neto	20%
Pajisje informatike	Mbi vlerën kontabël neto	25%
Të tjera pajisje	Mbi vlerën kontabël neto	20%

### 3.4 Aktive afatgjata jo materiale

#### (i) Marrëveshjet e Koncesionit

Shoqëria njeh një aktiv jo-material që rrjedh nga një marrëveshje koncesionare shërbimesh, kur ajo ka të drejtën për të shitur energjinë elektrike të prodhuar nga infrastruktura e koncesionit. Kjo nuk është një e drejtë e pakushtëzuar për të marrë para, pasi ajo është e varur nga sasia e energjisë elektrike së prodhuar nga hidrocentrali. Një aktiv jo-material marrë në këmbim të ndërtimit ose përmirësimit në një marrëveshje koncesionare shërbimi fillimisht matet me vlerën e drejtë duke iu referuar vlerës së drejtë të shërbimeve të ofruara.

#### (ii) Kostot vijuese

Pas njohjes fillestare, aktivi jo-material matet me koston, e cila përfshin koston e kapitalizuara të huamarrjes, minus amortizimin dhe humbjet nga zhvlerësimi.

#### (iii) Amortizimi

Jeta e dobishme e pritshme e një aktivi jo-material në një marrëveshje koncesionare të shërbimeve është periudha nga momenti kur Shoqëria është në gjendje të përdorë infrastrukturën deri në fund të periudhës së koncesionit. Amortizimi llogaritet duke përdorur metodën lineare dhe njihet në fitimet/(humbjet) e periudhës. Jeta e dobishme e vlerësuar e koncesionit më datë 31 dhjetor 2020 është 22 vjet.

# KISI-BIO-ENERGJI Sh. p. k.

## Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

(shumat në Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

---

### 3.5 Zhvlerësimi

#### (i) Aktivet financiare

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Aktive financiare të rëndësishme individualisht testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor.

Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse. Çdo shpenzim i akumuluar i lidhur me një aktiv financiar i disponueshëm për shitje i njohur më parë në kapital, transferohet në shpenzime.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivet financiare të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse.

#### (ii) Aktivet jo-financiare

Vlera e mbetur e aktiveve jo-financiare të Shoqërisë, rishikohet në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka të dhëna për zhvlerësim. Nëse ka të dhëna të tilla atëherë vlerësohet vlera e rikuperueshme e aktivit.

Një humbje nga zhvlerësimi njihet nëse vlera e mbetur e një aktivi tejkalon vlerën e tij të rikuperueshme. Humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse.

### 3.6 Provizionet

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë flukse dalëse parash për shlyerjen e tij. Provizionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për rreziqet që lidhen me detyrimin në fjalë.

### 3.7 Njohja e të ardhurave

Të ardhurat nga shërbimet e ofruara njihen në pasqyrën e të ardhurave në varësi të fazës së përfundimit të transaksionit në datën e bilancit. Asnjë e ardhur nuk njihet nëse ka pasiguri të lartë lidhur me kryerjen e pagesës dhe kostove përkatëse.

### 3.8 Të ardhura dhe shpenzime financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejte nëpërmjet llogarisë fitim/humbje, dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

### 3.9 Tatimi mbi fitimin

Shpenzimi i tatimit mbi fitimin përfshin tatimin aktual të periudhës si dhe tatimin e shtyrë. Tatimi aktual dhe tatimi i shtyrë njihen drejtpërdrejt në pasqyrën e performancës përveç rasteve kur këto lidhen me zëra që njihen direkt në kapital ose në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse. Kompensimi midis aktiveve tatimore aktuale dhe detyrimeve tatimore aktuale ose midis aktiveve tatimore të shtyra dhe detyrimeve tatimore të shtyra kryhet vetëm nëse ekziston një e drejtë ligjore për të kompensuar këto shuma ose kur do të paguhet shuma neto e tyre apo do të realizohen aktivet dhe do të shlyhen detyrimet në të njëjtën kohë.

# KISI-BIO-ENERGJI Sh. p. k.

## Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

(shumat në Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

### (i) Tatimi aktual

Tatimi aktual është përlogaritje e tatimit mbi fitimin të pagueshëm në lidhje me fitimin e tatueshëm të periudhës kontabël aktuale duke përdorur normën e tatimit në fuqi në datën e raportimit si dhe sistemimet në lidhje me tatimin e pagueshëm për periudha të shkuara.

Aktivet dhe pasivet tatimore përlogariten në vlerën e pritshme që do të kompensohet ose do t'u paguhet autoriteteve tatimore. Për llogaritjen e vlerave u bëhet referencë normës tatimore dhe legjislacionit tatimor në fuqi në Republikën e Shqipërisë në datën e raportimit. Fitimi i tatueshëm i periudhës ndryshon nga fitimi neto i paraqitur në pasqyrën e performancës si pasojë e rregullimeve në zërat e ardhurave ose shpenzimeve të cilat janë tatur apo njohur si të zbritshme në periudha të tjera si dhe zërave të cilët nuk janë të tatueshëm apo të zbritshëm bazuar në legjislacionin tatimor në fuqi.

Drejtimi i shoqërisë në mënyre periodike vlerëson qëndrimet e mbajtura në përgatitjen e deklaratave tatimore për ato raste në të cilat parashikimet e legjislacionit tatimor në fuqi janë subjekt i interpretimeve nga ana e organeve tatimore shqiptare dhe krijon provizione aty ku është e përshtatshme.

### (ii) Tatimi i shtyrë

Tatimi i shtyrë njihet si pasojë e diferencave të përkohshme midis vlerës së mbartur të aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të përdorura për qëllime tatimore. Një aktiv tatimor i shtyrë njihet për të gjitha diferencat e përkohshme të zbritshme, humbjet tatimore dhe kreditimet tatimore të papërdorura, për aq sa ato ka mundësi të mbulohen nga përfitimet e ardhshme tatimore. Aktivet tatimore të shtyra rishikohen në çdo datë raportimi dhe zvogëlohen deri në masën që ka mundësi që të realizohet përfitimi tatimor. Aktivet tatimore të shtyra të panjohura rivlerësohen në çdo datë raportimi dhe njihen deri në atë vlerë që do të jetë e mundur për të mbuluar aktivet tatimore të shtyra me fitimin e tatueshëm të viteve të ardhshme.

Aktivi apo detyrimi tatimor i shtyrë nuk njihet për diferencat e përkohshme të lidhura me:

- njohjen e emrit të mirë;
- fitimet e papaguara nga investimet në filialet e huaja, degët, pjesëmarrjet dhe sipërmarrjet e përbashkëta në masën që investimi është i përhershëm i në kohëzgjatje përveçse kur është e dukshme që e dukshme që diferencat e përkohshme do të rimerren në të ardhmen e parashikueshme.

Aktivët dhe detyrimet tatimore të shtyra përlogariten sipas normës tatimore në fuqi në datën e raportimit.

## 3.10 Adoptimi i SKK 13

Sic shpjegohet dhe në shënimin 2.5, në përgatitjen e ketyre pasqyrave në përputhje me SKK të përmirësuar, Shoqëria ka aplikuar në retrospective parashikimet e SKK 13 "Aktivet Biologjike dhe Marrëveshjet e Koncesionit".

Si rezultat i adoptimit në retrospektivë të SKK 13, Shoqëria ka riprezantuar shumat e raportuara më parë për periudhat nga 1 janar 2015 dhe deri më 1 janar 2019, datë e celjes së pasqyrave financiare të periudhës krahasuese.

Efektet e adoptimit në retrospektivë të SKK 13 mbi kapitalin neto në datën më të hershme të pasqyrave krahasuese, pra 1 janar 2019, paraqiten në vijim. Efektet e detajuara mbi të ardhurat, shpenzimet dhe flukset monetare nuk janë paraqitur në mënyrë të detajuar pasi u vlerësua se të dhënat në vijim janë të mjaftueshme për të dhënë një pasqyrë të qartë të efekteve të cilat prekin vetëm zëra të limituar të pasqyrave financiare dhe konsitojnë në të ardhura apo shpenzime jomonetare.

### 3.10.1 Përmbledhje mbi kapitalin neto

	Shënime shpjeguese	1 janar 2019
Kapitali neto		202,659,074
Rregullim në rritje i amortizimit të akumuluar të AAM	3.10.2 a(ii)	(3,971)
Rregullim në ulje i amortizimit të akumuluar të AAJM	3.10.2 b(ii)	9,667,218
<b>Totali i kapitalit neto</b>		<b>212,322,321</b>

# KISI-BIO-ENERGJI Sh. p. k.

## Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

(shumat në Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

### 3.10.2 Rikonçilimi i kapitalit neto më 31 dhjetor 2018

	Shënime shpjeguese	1 janar 2019	Efektet e adoptimit të SKK 13	1 janar 2019 (rishikuar)
<b>Aktivet</b>				
<b>Aktivet afatshkurtra</b>				
Mjete monetare		36,778	-	36,778
Të drejta të arkëtueshme		21,577,458	-	21,577,458
Shpenzime të shtyra		-	-	-
<b>Totali i aktiveve afatshkurtra</b>		<b>21,614,236</b>	<b>-</b>	<b>21,614,236</b>
<b>Aktivet afatgjata</b>				
Aktive financiare		-	-	-
Aktive materiale	<b>a</b>	378,737,992	(378,537,901)	200,091
Aktive jo materiale	<b>b</b>	-	388,201,148	388,201,148
Aktive tatimore të shtyra		-	-	-
<b>Totali i aktiveve afatgjata</b>		<b>378,737,992</b>	<b>9,663,247</b>	<b>388,401,239</b>
<b>Totali i aktiveve</b>		<b>400,352,228</b>	<b>9,663,247</b>	<b>410,015,475</b>
<b>Detyrime dhe kapitali</b>				
<b>Detyrime afatshkurtra</b>				
Detyrime afatshkurtra		66,977,136	-	66,977,136
Të ardhura të shtyra		-	-	-
Provizione		-	-	-
<b>Totali i detyrimeve afatshkurtra</b>		<b>66,977,136</b>	<b>-</b>	<b>66,977,136</b>
<b>Detyrime afatgjata</b>				
Detyrime afatgjata		130,716,018	-	130,716,018
<b>Totali i detyrimeve afatgjata</b>		<b>130,716,018</b>	<b>-</b>	<b>130,716,018</b>
<b>Totali i detyrimeve</b>		<b>197,693,154</b>	<b>-</b>	<b>197,693,154</b>
<b>Kapitali dhe rezervat</b>				
Kapitali i nënshkruar		194,900,000	-	194,900,000
Rezerva		76,635	-	76,635
Fitimi (humbja) i pashpërndarë	<b>c</b>	7,682,439	9,663,247	17,345,686
Fitimi (humbja) e vitit		-	-	-
<b>Totali i kapitalit neto</b>		<b>202,659,074</b>	<b>9,663,247</b>	<b>212,322,321</b>
<b>Totali i detyrimeve dhe kapitalit neto</b>		<b>400,352,228</b>	<b>9,663,247</b>	<b>410,015,475</b>

Në vijim shpjegohen rregullimet materiale në Pasqyrën e Pozicionit Financiar të Shoqërisë:

#### a. Aktive Afatgjata Materiale ("AAM")

(i) Riklasifikim në Aktivet Afatgjata Jo Materiale	(378,533,930)
(ii) Rregullim i amortizimit të akumuluar të Aktiveve Afatgjata Materiale	(3,971)
<b>Ndikimi neto – ulje në vlerën e Aktiveve Afatgjata Materiale</b>	<b>(378,537,901)</b>

- (i) Riklasifikuar nga "Aktive Afatgjata Materiale" tek "Aktivet Afatgjata Jo Materiale" ("AAJM") vlera neto kontabël më 31 dhjetor 2018 e investimit në HEC prej 378,737,992 Lekë e cila në përputhje me kërkesat e SKK 13 përbën thelbësisht vlerën e të drejtave koncesionare në kuptim të këtij standardi dhe si rrjedhojë duhet të paraqitet dhe amortizohet sipas kërkesave të këtij standardi në grupin e AAJM.

# KISI-BIO-ENERGJI Sh. p. k.

## Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

(shumat në Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

- (ii) Rregullim i amortizimit të akumuluar të Aktiveve Afatgjata Materiale në shumën 3,971 Lekë si rrjedhojë e identifikimit të aplikimit të normës së gabuar të amortizimit mbi aktivet e këtij grupi për vitet 2015-2018.

### *b. Aktive Afatgjata Jo Materiale ("AAJM")*

(i) Riklasifikim i vlerës së investimit në HEC	378,533,930
(ii) Rregullim në ulje i amortizimit të akumuluar të AAJM	9,667,218
<b>Ndikimi neto – rritje në vlerën neto kontabël të Aktiveve Afatgjata Jo Materiale</b>	<b>388,201,148</b>

- (i) Shih shënimin a(i).

- (ii) Vlera e amortizimit të akumuluar të AAJM është rishikuar si pasojë e adoptimit të metodës lineare të amortizimit dhe ndryshimeve në jetën e dobishme të aktivitetit e cila është rishikuar bazuar në kohën e mbetur nga periudha e koncesionit përcaktuar në Kontratën e Koncesionit. Rillogaritja e amortizimit është kryer në retrospektivë për periudhat duke filluar nga 1 janari 2015, datë e hyrjes në fuqi të SKK 13 "Aktivet biologjike dhe marrëveshjet koncesionare".

### *c. Fitimet (humbjet) e akumuluar*

(i) Korrigjim i amortizimit të akumuluar të Aktiveve Afatgjata Materiale	(3,971)
(ii) Korrigjim në ulje i amortizimit të akumuluar të AAJM	9,667,218
<b>Ndikimi neto – rritje në fitimet e akumuluar</b>	<b>9,663,247</b>

- (i) Shih shënimin a(ii).

- (ii) Shih shënimin b(ii).

# KISI-BIO-ENERGJI Sh. p. k.

## Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

(shumat në Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

### 4. Mjetet monetare

Mjetet monetare më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 janë përbërë si më poshtë:

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019 (rishikuar)
Llogari rrjedhëse:		
Në Lek	11,195,569	12,078
Në Euro	131,230	11,583
Arka:		
Në Lek	75,269	75,269
<b>TOTALI</b>	<b>11,402,068</b>	<b>98,930</b>

### 5. Të drejta të arkëtueshme

Të drejtat e arkëtueshme më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 janë përbërë si më poshtë:

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019 (rishikuar)
Të arkëtueshme nga klientët	3,895,565	8,190,690
TVSH e arkëtueshme	6,106,850	9,058,331
Paradhënie për furnitorë	1,236,600	-
Paradhënie për tatimin mbi fitimin	1,116,965	1,316,945
<b>TOTALI</b>	<b>12,355,980</b>	<b>18,565,966</b>

### 6. Aktive afatgjata materiale

Aktivet afatgjata materiale më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 janë përbërë si më poshtë:

	Pajisje informatike	Mobilje dhe orendi	Të tjera pajisje	Totali
<i>Kosto</i>				
Më 31 dhjetor 2018	139,042	207,700	-	346,742
Shtesa	-	-	-	-
Pakësime	-	-	-	-
Më 31 dhjetor 2019	139,042	207,700	-	346,742
Shtesa	64,158	-	153,650	217,808
Pakësime	-	-	-	-
Më 31 dhjetor 2020	203,200	207,700	153,650	564,550
<i>Amortizimi i akumuluar</i>				
Më 31 dhjetor 2018	28,735	117,916	-	146,651
Amortizimi për vitin	27,577	17,957	-	45,533
Më 31 dhjetor 2019	56,312	135,873	-	192,185
Amortizimi për vitin	20,682	14,365	-	35,048
Më 31 dhjetor 2020	76,994	150,238	-	227,232
<i>Vlera e mbetur</i>				
Më 31 dhjetor 2018	110,306	89,784	-	200,091
Më 31 dhjetor 2019	82,730	71,827	-	154,557
Më 31 dhjetor 2020	126,206	57,462	153,650	337,318



# KISI-BIO-ENERGJI Sh. p. k.

## Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

(shumat në Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

### 8. Aktive afatgjata jo materiale

	Të drejta koncesionare	Totali
<i>Kosto</i>		
Më 31 dhjetor 2018	438,441,383	438,441,383
Shtesa	-	-
Pakësime	-	-
Më 31 dhjetor 2019	438,441,383	438,441,383
Shtesa	34,196,950	34,196,950
Pakësime	-	-
Më 31 dhjetor 2020	472,638,333	472,638,333
<i>Amortizimi i akumuluar</i>		
Më 31 dhjetor 2018	50,240,234	50,240,234
Amortizimi për vitin	15,889,028	15,889,028
Më 31 dhjetor 2019	66,129,262	66,129,262
Amortizimi për vitin	17,012,989	17,012,989
Më 31 dhjetor 2020	83,142,251	83,142,251
<i>Vlera e mbetur</i>		
Më 31 dhjetor 2018	388,201,149	388,201,149
Më 31 dhjetor 2019	372,312,121	372,312,121
Më 31 dhjetor 2020	389,496,082	389,496,082

Si rezultat i ndryshimeve në politikat kontabël të përkrahura në politikën kontabël 2.5, Shoqëria ka transferuar aktivet koncesionare nga aktive afatgjata materiale në aktive jo materiale. Kostot e ndërtimit përfshijnë shpenzimet për licencat, inxhinieri dhe punë civile, pajisjet elektrike dhe hidro-mekanike, konsulentë, dizejnim, vlerësimin e ndikimit në mjedis, monitorimin ekologjik dhe mbikëqyrje në zonën e ndërtimit. Vlera e drejtë e aktiveve afatgjata jo materiale vlerësohet të jetë e njëjtë me vlerën e investimit pakësuar me amortizimin e akumuluar.

Më datë 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 Drejtimi i Shoqërisë doli në përfundimin se nuk ka ndryshime të rëndësishme/ materiale të supozimeve për llogaritjen e vlerës së drejtë dhe për këtë arsye nuk është bërë ndonjë llogaritje për zhvleresime të mundshme dhe nuk është njohur ndonjë rezervë për këtë qëllim.

### 9. Detyrime afatshkurtra

Detyrimet afatshkurtra më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 janë përbërë si më poshtë:

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019 (rishikuar)
Të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit	14,043,893	4,443,322
Të pagueshme ndaj punonjësve	-	467,079
Të pagueshme për kontribute	183,088	130,543
Të pagueshme për tatimin mbi të ardhurat nga punësimi	155,798	35,614
Të pagueshme për tatimin e mbajtur në burim	32,206	-
Detyrime të tjera	-	35,672,090
<b>TOTALI</b>	<b>14,414,985</b>	<b>40,748,648</b>

### 10. Detyrime afatgjata

Detyrimet afatgjata më 31 dhjetor 2020 në vlerë 157,992,941 Lekë dhe më 31 dhjetor 2019 në vlerën 148,835,713 Lekë konsistojnë në paradhënie nga ortakët për financimin e veprimtarive operacionale dhe investuese të Shoqërisë. Vlera e detyrimeve në monedhën origjinale më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 është e përbërë nga financim në monedhën vendase në shumën 25,426.76 Lek dhe nga financim në monedhën Euro në shumën 1,277,021 Euro dhe 1,222,021 Euro, respektivisht për secilin vit. Vlerat e detyrimeve afatgjata në monedhën Euro më 31 dhjetor 2020 është rivlerësuar me kursin e këmbimit publikuar nga Banka e Shqipërisë prej 123.70 Lek/Euro (31 dhjetor 2019: 121.77 Lek/Euro).

# KISI-BIO-ENERGJI Sh. p. k.

## Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

(shumat në Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

### 11. Të ardhurat nga shitja

Të ardhurat nga shitja përbëhen si më poshtë:

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2020	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2019 (rishikuar)
Të ardhura nga shitja e energjisë	38,118,963	27,149,572
<b>TOTALI</b>	<b>38,118,963</b>	<b>27,149,572</b>

### 12. Shpenzime të personelit

Shpenzimet e personelit përbëhen nga pagat dhe kontributet për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore si më poshtë:

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2020	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2019 (rishikuar)
Paga dhe shpërblime	10,258,373	5,540,195
Shpenzime të sigurime shoqërore dhe shëndetësore	1,293,728	910,182
<b>TOTALI</b>	<b>11,552,101</b>	<b>6,450,377</b>

### 13. Shpenzime të tjera shfrytëzimi

Shpenzimet e tjera të shfrytëzimit përbëhen si më poshtë:

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2020	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2019 (rishikuar)
Shpenzime për tarifa rregullatore dhe të ngjashme	315,916	458,333
Shpenzime qiraje	258,621	35,159
Shpenzime për tarifën koncesionare	762,359	67,810
Shpenzimi për energji elektrike dhe të ngjashme	6,667	543,012
Shpenzime mirëmbajtje	1,270,878	69,171
Shpenzime noteriale	10,900	115,932
Shpenzime për sigurime	80,726	114,818
Shpenzime për shërbime dhe konsulence teknike	55,000	-
Shpenzime anëtarësimi	73,379	1,333,414
Shpenzime për detyrime tatimore, gjoba dhe interesa	279,427	-
Shpenzime për shërbime konsulence profesionale	1,409,044	-
Komisionet dhe shërbimet bankare	116,088	54,945
Taksa dhe tarifa vendore	975,118	516,592
Shpenzime postare dhe telekomunikacioni	58,779	770,108
Shpenzime zyre të ndryshme	9,892	2,206,220
Shpenzime transporti	167,647	3,060
<b>TOTALI</b>	<b>5,850,441</b>	<b>6,288,574</b>

### 14. Të ardhura (shpenzime) nga interesat dhe të ngjashme, neto

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2020	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2019 (rishikuar)
Të ardhura nga interesi për huatë e dhëna	-	1,660,030
Të ardhura të tjera financiare	-	77
Shpenzime interesi për hua dhe overdrafte	(293)	(10,505,104)
<b>TOTALI</b>	<b>(293)</b>	<b>(8,844,997)</b>

# KISI-BIO-ENERGJI Sh. p. k.

## Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

(shumat në Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

### 15. Të ardhura (shpenzime) nga kursi i këmbimit, neto

Të ardhurat (shpenzimet) nga kursi i këmbimit, neto përbëhen si më poshtë:

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2020	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2019 (rishikuar)
Fitime të realizuara nga kursi i këmbimit	297,363	366,920
Fitime të porealizuara nga kursi i këmbimit	159,672	-
	<b>457,035</b>	<b>366,920</b>
Humbje të realizuara nga kursi i këmbimit	(879,601)	(112,847)
Humbje të porealizuara nga kursi i këmbimit	(2,536,169)	-
	<b>(3,415,770)</b>	<b>(112,847)</b>
<b>TOTALI</b>	<b>(2,958,735)</b>	<b>254,073</b>

### 16. Shpenzimi i tatimit mbi fitimin

Bazuar në legjislacionin shqiptar, norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2020 dhe 2019 është 5% për tatimpaguesit me qarkullim vjetor deri në 14 milionë Lek dhe 15% për tatimpaguesit me qarkullim vjetor mbi këtë shumë.

Deklaratat tatimore dorëzohen çdo vit por të ardhurat dhe shpenzimet e deklaruar për qëllime tatimi konsiderohen vetëdeklarime deri në momentin që autoritetet tatimore shqyrtojnë deklaratat dhe regjistrimet e tatimpaguesit dhe lëshojnë vlerësimin final. Ligjet dhe rregullat tatimore shqiptare janë objekt interpretimi nga autoritetet tatimore.

#### (i) Shpenzimi i tatimit mbi fitimin aktual

Fitimi i tatueshëm dhe shpenzimi i tatimit mbi fitimin për vitet 2020 dhe 2019 paraqiten në vijim:

	2020	2019
Të ardhura	38,575,998	29,176,598
Shpenzimet	(37,866,641)	(39,291,462)
<b>Rezultati kontabël</b>	<b>709,357</b>	<b>(10,114,864)</b>
<i>Rregullime për diferenca të përkoshme:</i>		
Shpenzime të përlogaritura	-	-
<b>Fitimi/(humbja) pas rregullimeve</b>	<b>709,357</b>	<b>(10,114,864)</b>
<b>Shpenzime të panjohura:</b>		
Shpenzime mirëmbajtjeje	245,000	-
Shpenzime pa faturë tatimore	640	2,206,220
Gjoha dhe dëmshpërblime	279,427	1,333,414
Shpenzime amortizimi të panjohura	14,365	-
Shpenzime jo korrente	126,913	10,632,022
<b>Totali i shpenzimeve të panjohura</b>	<b>666,345</b>	<b>14,171,656</b>
<b>Fitimi/(humbja) tatimore për periudhën</b>	<b>1,375,702</b>	<b>4,056,792</b>
<b>Shpenzimi për tatimin mbi fitimin:</b>		
Tatimi mbi Fitimin me normën 5%	-	-
Tatimi mbi Fitimin me normën 15%	206,355	608,519
<b>Totali</b>	<b>206,355</b>	<b>608,519</b>

# KISI-BIO-ENERGJI Sh. p. k.

## Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

(shumat në Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

### Rikoncilimi i normës efektive të tatimit:

	2020	%	2019	%
Fitimi/(Humbja) e periudhës para tatimit	709,357	100%	(10,114,864)	100%
Fitimi/(Humbja) tatimore me shkallën tatimore standarde	106,404	15.00%	(1,517,230)	15.00%
<i>Shpenzime të panjohura:</i>				
Shpenzime mirëmbajtjeje	36,750	5.18%	-	0.00%
Shpenzime pa faturë tatimore	96	0.01%	330,933	-3.27%
Gjoha dhe dëmtshpërblime	41,914	5.91%	200,012	-1.98%
Shpenzime amortizimi të panjohura	2,155	0.30%	-	0.00%
Shpenzime jo korrente	19,037	2.68%	1,594,803	-15.77%
<b>TOTALI</b>	<b>206,355</b>	<b>29.09%</b>	<b>608,519</b>	<b>-6.02%</b>

### (ii) E ardhura (shpenzimi) për tatimin e shtyrë

E ardhura (shpenzimi) për tatimin e shtyrë i njohur nga Shoqëria për vitet 2020 dhe 2019 është zero pasi nuk evidentohen diferenca materiale midis trajtimeve fiskale dhe kontabël për aktivet dhe detyrimet e Shoqërisë.

### 17. Transaksionet me palët e lidhura

Në datën e raportimit, shumat e mëposhtme u korrespondojnë ortakëve të Shoqërisë si dhe shoqërive të kontrolluara:

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
<i>Detyrime ndaj palëve të lidhura:</i>		
Detyrime afatgjata kundrejt FreeCo Sh.p.k. për financime	157,992,941	148,835,713
<i>Volumi i transaksioneve me palët e lidhura</i>		
Arkëtime për financime nga FreeCo Sh.p.k.	(6,829,350)	(18,119,695)

### 18. Angazhime dhe pasiguri

Gjatë aktivitetit të saj të zakonshëm, Shoqëria mund të përfshihet në pretendime apo veprime të ndryshme ligjore nga palë të treta. Bazuar në opinionin e drejtuesve të Shoqërisë, konkluzioni përfundimtar në lidhje me këto çështje nuk do të ketë efekte negative në pozicionin financiar të Shoqërisë ose ndryshime në aktivet neto të saj.

### 19. Ngjarje të mëpasshme

Nuk ka asnjë ngjarje të mëpasshme pas datës së raportimit e cila kërkon rregullime apo shpjegime në këto pasqyra financiare.